



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2020:088947
Datë: 17.05.2022
Numri i dokumentit: 03021909

C.nr.1012/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Binak Duqi, dhe procesmbajtësen Naile Ismajli, në çështjen juridike kontestimore të paditëses R. Z. R. nga fshati S. i P. K. Podujevës, tani me vendqëndrim ne Prishtine të cilin e përfaqëson i autorizuari O. M., avokat nga Prishtina, Rruga “M. B.” nr..., me autorizim, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit nga Podujeva, Rruga “N. Gashi” pn, me objekt kontesti Pagesa e pagave për shpërblimi jubilar, kompensimin e ushqimit ditor si dhe shpenzimet e udhëtimit, me vlerë të kontestit: 2,458.86 Euro, jashtë seance me dt.17.05.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M
-pa shqyrtim kryesor të çështjes –

APROVOHET pjesërisht padia dhe kërkesëpadia e paditëses R. Z. R. nga fshati S. i P. K. nga Podujevës, tani me vendqëndrim ne Prishtine **si e bazuar**,

DETYROHET e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses, R. Z. R. nga fshati S. i P. K. Podujevës, tani me vendqëndrim ne Prishtine t’ia kompensojë në emër të shpërblimit jubilar për përvojën e punës një (1) page bazë me 100% te pagës, në lartësi prej 393.00, ndërsa llogaritur 50% e pagës i bie për pagese shuma prej 196.50 Euro, kompensimin për periudhën kohore 18.04.2017 deri më 18.04.2021 të Ushqimit ditor për ditët e pranisë në punë për 662 ditë pune, nga 2 euro shumën prej 1.324.00 euro si dhe shpenzimet e udhëtimit për 662 dite nga 1.00 euro te llogaritur me 70% te biletës ne dite i bie shuma prej 463.40 euro. Te të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 1,983.90 Euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 174.00 Euro, të gjitha në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarrimit.

REFUZOHET kërkesa e paditëses në emër të shpërblimit jubilar për pagesën e një page bazë dhe shpenzimet e udhëtimit përtej shumës së aprovuar në vlerë prej 475.50 Euro dhe atë (12.10 euro për pagën baze dhe 463.40euro për shpenzimet e udhëtimit) **si e pa bazuar**.

DETYROHET paditësja R. Z. R. nga fshati S. i P., K. Podujevës, tani me vendqëndrim ne Prishtine, që në emër të taksës gjyqësore shtesë për padi të paguajë shumën prej 10.00 Euro, në llogarinë e gjykatës, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi, me datën 28.07.2020 ka paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin e ushqimit shpenzimeve te udhëtimit si dhe shpërblimit jubilar, të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës 14.02.2022, në aspektin objektiv për kompensimin për shpërblim jubilar, për shujta për ditët e punës si dhe shpenzimet e udhëtimit, për secilën dite te prezencës ne pune (vajtje-ardhje) ne relacionin prej Prishtine ne fshatin S. K. Podujevës si dhe anasjelltas nga 1 euro njeri drejtim dhe anasjelltas 2 euro, me autobusin e Kompanisë se autobusëve “B. R.” nga Podujeva, ashtu që ka kërkuar shumën e përgjithshme prej 2458.86€.

Ka shtuar se është në marrëdhënie të rregullt pune pa ndërprerë tek e paditura ku punon si mësimdhënës ne SHFMU “P.” ne fshatin S. K. Podujevës dhe ka mbi 10 vite përvojë pune. Ka theksuar se duke marrë parasysh nënshkrimin e Kontrata kolektive të Arsimit të Kosovës, të datës 18.04.2017, dhe të drejtave të cilat njihen në këtë kontratë kompensimi për ushqim, pagesa e pagës jubilarë si dhe shpenzimet e udhëtimit. Të cilat prej ditës së nënshkrimit e deri në momentin e parashtrimit të kësaj padie nuk i është paguar shuma e kërkuar nga e paditura. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që të bëjë pagesën-kompensimin e shpërblimit jubilar për përvojën e punës, kompensimin e ushqimit ditorë për ditët e pranisë në punë, si dhe shpenzimet e udhëtimit për ditët e udhëtimit ne relacionin Prishtine- S. K. Podujevës dhe anasjelltas për 662 dite nga 2 euro apo 1 euro njeri drejtim, kjo sipas parashtrësës për rregullimin e padisë të datës 14.02.2022, bazuar në ligjin në fuqi dhe kontratës kolektive, njëherit ka kërkuar që të detyrohet e paditura që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, i ka pohuar faktet vendimtare duke theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit, për pagesën e pagave jubilarë, pagesën e shpenzimeve për ushqim gjatë punës si dhe ato për udhëtim sepse pala paditëse ka ofruar dëshmi- vërtetim lidhur me udhëtimin e bere nga N.P.L “S. i A.” SH.A nga e cila ne ndërkohe ne kemi pranuar një shkresë me dt. 25.02.2022 dhe nga e njëjta shifet se kjo ndërmarrje i ka anuluar te gjitha vërtetimet e lëshuara dhe i ka shpallur te pavlefshme te gjitha ato vërtetime te lëshuara sipas kërkesës se mësimdhënësve dhe te cilën shkresë ia kemi dorëzuar dhe gjykatës.

Metej ka theksuar se padia nuk ka bazë juridike, ngase me dispozitat të kontratës kolektive në fuqi nga dt.18.04.2017, në nenin 46 të saj është paraparë se: MASHT-i dhe SBASHK-u, angazhohen bashkërisht për ndarjen e mjeteve financiare për pagesën e obligimeve sipas dispozitave të nenit 35 paragrafët 7 dhe 8, ndërsa e paditura nuk ka buxhet për kryerjen e këtyre obligimeve ndaj punëtorëve të arsimit. Po ashtu kjo kontratë kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me kontratën kolektive. Gjithashtu ka kundërshtuar pagën bazë të paditësit ngase e njëjta nuk korrespondon me pagën bazë të tij e cila nga lista e pagave shihet se shuma 50% e pagës bazë te paditësit prej shumes 393.00 euro është 196.50 euro e jo 208.60 euro siç kërkon pala paditëse.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për pagesën e pagave jubilarë dhe kompensimin e shujtave ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura për më shumë se 10 vite përvojë pune, po ashtu nuk është kontestuese se e paditura nuk i ka paguar paditësit pagesën e ushqimit ditorë si dhe shpenzimet e udhëtimit për relacionin Prishtinë- S. K. Podujevës me Kompaninë “B. R.” nga Podujeva, për ditët e pranisë se tij në punë si dhe të një (1) page të pagës bazë në emër të shpërblimit jubilar pasi që një gjë e tillë nuk kontestohet nga palët, kjo vërtetohet dhe me provat materiale në shkresat e lëndës.

Andaj, gjykata konform nenit 152 dhe 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, konkretisht nenin 35 par.7 është paraparë se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim.”*, ndërsa në par.8 nën par.8.3. të saj ku është e përcaktuar se: *“Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë.”*, por këtë nuk e ka bërë e paditura edhe pse ka qenë e obliguar ta bëjë këtë.

Po ashtu kjo është e rregulluar dhe me Ligjin nr.03/L-212 e Punës, sipas nenit 90 par.4 të tij ku thuhet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3 (tri) vjet.”*, siç është dhe me këtë Kontratë (e cila ka qenë në fuqi konform nenit 45 par.2 të saj, deri me datën 22.01.2021), e që kjo çështje është rregulluar njëjtë dhe me dispozitat e nenit 35 par.7 dhe 8 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë në fuqi nga data 22.01.2021 të cilat gjejnë zbatim në rastin e paditësit.

Gjykata lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë vendosi duke u bazuar në Listën e pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës e cila gjendet në shkresat e lëndës, lëshuar në emër të paditësit, nga e cila vërtetohet fakti se paditësi ka realizuar pagën bazë në vlerë prej 393.00 Euro dhe 50% e saj i bie te jete 196.50 e jo siç kërkohet shuma prej 208.09 euro, nga e cila po ashtu vërtetohet fakti se paditësi ka 10 vite eksperiencë (përvojë pune), si provë. Ndërsa lartësia e kompensimit për shujtë u vendos bazuar në Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “P.” ne S. K. Podujevës me nr./2022 dt. 08.02.2022, mbi ditët e pranisë në punë të paditësit (duke iu llogaritur shujta nga 2 euro për një ditë të pranisë në punë, ndërsa lidhur me shpenzimet e udhëtimit gjykata vendosi atë konform Kontratës Kolektive te Arsimit ne Kosove neni 35.5 ku i hiqen shpenzimet e udhëtimit për biletën ditore dhe atë 70% te saj, prej fshatit L. i P. e deri ne S. e anasjelltas, sepse Ky fshat bie ne territorin e Komunës se Podujevës dhe shpenzimet i njihen vetëm ne territorin

ku punon e jo prej Prishtine kjo konform nenit 35.5 te Kontratës Kolektive te Arsimit ne Kosove dr.18.04.2017si dhe bazuar ne vërtetimin e Kompanisë se autobusit "B. R." ne Podujeve, si provë, me ç 'rast kemi të bëjmë me një dokument publik i cili ka fuqi të plotë provuese, e që në anën tjetër e paditura nuk i ka rrëzuar me prova materiale fuqinë provuese të këtij dokumenti, e gjithë kjo dhe bazuar në dispozitën e lart cituar të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, konkretisht nenit 35 par.7 dhe 8 të saj.

Gjykata i konsideron si të papranueshme dhe të pabazuara pretendimet dhe kundërshtimet e paditurës se ajo nuk ka asnjë obligim ndaj paditësit me arsyetim se nuk ka buxhet për të bërë këto pagesa të pagave jubilarë, shpenzimeve të udhëtimit dhe shujtave të ushqimit, për çka edhe i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Ju refuzua kërkesa e paditëses në emër të shpërblimit jubilar për pagesën e një page bazë, përtej shumës së aprovuar në vlerë prej 12.10 €, si e pa bazuar, ngase e njëjta është në kundërshtim me provat e lartcekura, mbi bazën e të cilave gjykata vendosi mbi lartësinë e kërkesëpadisë, nga të cilat shihet se paditësi realizon **pagën bazë** me 50% prej 393 euro në vlerë prej 196.50 euro, andaj ju refuzua kërkesa në vlerën e cekur më lartë, si e pa bazuar ngase e njëjta është dhe në kundërshtim me dispozitën e nenit 35 par.8 nën par.8.3, e cila ka përcaktuar se: "*Punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë.*" Gjithashtu paditëses ju refuzua dhe shuma prej 300.60 euro për shpenzimet e udhëtimit sepse i pranohen sipas Kontratës Kolektive te Arsimit ne Kosove 18.04.2017 vetëm 70% te shpenzimeve për bilet te udhëtimit dhe atë për relacionin L. i P.- S. e jo prej Prishtine duke iu refuzuar shuma prej 463.40 euro apo gjithsejta 475.50 euro. Kjo bazuar ne nenin 35.5 te Kontratës Kolektive te Arsimit ne Kosove.

Kamatë vonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 382 të Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e palëve dhe provat tjera të ofruara, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes kontestimore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449, 450,452 dhe 453.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore si dhe Rregullores për Tarifat e Avokatëve e Odës së Avokatëve të Kosovës (2017). Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet për përpilimin e padisë shuma prej 104 euro, precizimin e kërkesëpadisë ne shumën prej 50.00 euro si dhe taksave gjyqësore të paguara për padi në shumë prej 20 eurove, duke marrë për bazë vetëm ato shpenzime të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë. Ndërsa pjesa e tjetër e kërkuar e shpenzimeve iu refuzua si e pa bazuar dhe sipas suksesit ne kontest neni 452.2 te LPK –se- pasi qe pala paditëse pjesërisht pati sukses ne kontest edhe shpenzimet iu aprovuan pjesërisht atij.

Vendimi lidhur me detyrimin e paditësit për pagesën e taksës shtesë për padinë e ushtruar në gjykatë, u mor konform dispozitave të nenit 253.1 dhe 4 të LPK-së, si dhe nenit 12.1 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, duke detyruar paditësin që në emër të taksës gjyqësore shtesë për padi të paguajë shumën prej 10€, në bazë të vlerës së kërkesëpadisë të saktësuar me parashtrësën e datës 14.02.2022, meqë gjykata nuk ka dëshmi se është paguar nga paditësi, ngase me rastin e dorëzimit të padisë në gjykatë është paguar vetëm taksa gjyqësore në shumën prej 20.00 €.

Numri i lëndës: 2020:088947
Datë: 17.05.2022
Numri i dokumentit: 03021909

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1012/2020, me datën 17.05.2022**

**Gjyqtari:
Binak Duqi**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.